



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit

RAPORT

**PËR SHQYRTIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT NR.3358,
DATË 3.06.2002 “PËR KTHIMININ E LIGJIT NR. 8893, DATË
14.05.2002 “PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.8269, DATË 23
12.1997 “PËR BANKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME
LIGJIN NR.8384, DATË 29.07.1998”**

Komisioni i Ekonomisë në mbledhjen e datës 3.07.2002 shqyrtoi Dekretin e Presidentit nr.3358, datë 3.06.2002 “Për kthimin e ligjit nr. 8893, datë 14.05.2002 “Për disa shtesa në ligjin nr.8269, datë 23 12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998”

Gjatë shqyrtimit të Dekretit, Komisioni i Ekonomisë mbështeti motivin e Presidentit për kthimin e ligjit nr. 8893, datë 14.05.2002 “Për disa shtesa në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998” dhe është dakort, që neni 6 i këtij ligji të ndryshohet, duke mos e ndryshuar përmbajtjen e nenit 46 të ligjit nr.8269, datë 23 12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, por duke i shtuar këtij neni një paragraf tjetër, siç është propozuar nga Presidenti.

Duke marrë në konsideratë motivin e Presidentit për kthimin e ligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.8269, datë 23 12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” rezulton se neni 6 i ligjit nr. 8893, datë 14.05.2002 “Për disa shtesa në ligjin nr.8269, datë 23 12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.8384, datë 29.07.1998” duhet të ndryshohet si vijon:

“Neni 6

Në nenin 46 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Funksioni i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës është i papajtueshëm me atë të punonjësit, administratorit dhe aksionerit, me pjesmarrje ndikuese në bankën e nivelit të dytë ose në subjekte që licencohen nga Banka e Shqipërisë.””

*at kom
Ligji 46*

Tiranë më 3.07.2002

**KRYETARI I KOMISIONIT
Ylli BUFI**



REPUBLICA E SHQIPERISE
KUVENDI
KOMISIONI PER ÇESHTJET KUSHTETUESE DHE LIGJORE

RELACION

Per Dekretin e Presidentit nr.3358, date 3.06.2002, "Per khtimin e ligjit nr. 8893, date 14.5.2002 "Per disa shtesa dhe ndyshime ne ligjin nr. 8269, date 23.12.1997 "Per banken e Shqiperise, ndryshuar me ligje te tjera.

Komisioni i Ligjeve ne mbledhjen e dates 10.07.2002 mori ne shqyrtim Dekretin e Presidentit nr.3358, date 3.06.2002, "Per khtimin e ligjit nr. 8893, date 14.5.2002 "Per disa shtesa dhe ndyshime ne ligjin nr. 8269, date 23.12.1997 "Per banken e Shqiperise, ndryshuar me ligje te tjera.

Komisioni, pasi u njoh me dekretin, diskutoi per bazueshmerine ligjore dhe konstatoi qe ne kendveshtrimin ligjor p/ligji eshte konform Kushtetutes, konkretisht te nenit 85 pika 1 te saj.

Gjate diskutimit ne komision u shfaqen 2 mendime:

Mendimi i shumices, i cili mbeshtet Dekretin e Presidentit, e konkretisht Ne nenin 46, pas paragrafit egzistues shtohet paragrafi "Funkcioni i anetarit te Keshillit mbikqyres eshte i papajtueshem me ate te punonjesit, administratorit dhe aksionerit, me pjesmarrje ndikuese ne banken e nivelit te dyte ose ne subjektet qe licensohen nga Banka e Shqiperise".

Dhe mendimi i pakices sipas te cilit ne nenin 46, pas paragrafit egzistues te shtohet paragrafi "Funkcioni i anetarit te Keshillit mbikqyres eshte i papajtueshem me ate te punonjesit, administratorit dhe aksionerit, me pjesmarrje ndikuese ne banken e nivelit te dyte ose ne subjektet qe licensohen nga Banka e Shqiperise" por duke hequr fjalet "me pjesmarrje ndikuese"

Ne perfundim me shumice votash ne komision u pranua mendimi i pare dhe **komisioni shpehet dakort per kalimin e ketij dekreti ne séance plenare.**

KRYETAR

Spartak BRAHO

Boshic.
edhe 16m
elkom

Shumice

Pakica